



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2023 – Numri: 10

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 20 janar 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 16, datë 18.1.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 769
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 18.1.2023	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 122, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit–Rruga e Kavajës)’, të ndryshuar”..... 769
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 18.1.2023	Për mbylljen e misionit të posaçëm të Republikës së Shqipërisë në Kiev, Ukrainë..... 772
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 18.1.2023	Për hapjen e misionit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin e Ukrainës, Kiev..... 772
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 18.1.2023	Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e rikonceptimit të komplekseve sportive të stadiumeve në qytetet e Durrësit, Korçës dhe Vlorës..... 772
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 18, datë 18.1.2023	Për miratimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor..... 773
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 18.1.2023	Për miratimin e ndryshimit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” vresht në “tokë urbane” truall të sipërfaqes 390.99 m ² , pjesë e pasurisë me numër 1/394, dhe të sipërfaqes 269.13 m ² , pjesë e pasurisë me numër 2/465, zona kadastrale 1476, Bashkia Dropull..... 776
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 18.1.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 298, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”..... 789
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 18.1.2023	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”..... 789

Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 10, datë 19.1.2023	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 207, datë 28.10.2022, “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore”.....	789
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 13.1.2023	Për delegimin e kompetencave.....	790
	Korrigjim gabimi material në vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 311, datë 21.11.2022, “Për miratimin e rregullores ‘Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 165, datë 13.12.2022.....	790

**DEKRET**

Nr. 16, datë 18.1.2023

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 13, nenit 14, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Denis Nazmi Alla
2. Rozeta Bujar Karapetsas (Mehmet)
3. Dhora Sotir Tego
4. Olti Xhako Lamçellari
5. Adeo Sabri Lybesha
6. Liridona Niman Hajdarmataj
7. Fedona Nikolin Metalini
8. Greta Sigurim Spaha
9. Abiel Klevis Gjergji
10. Klotilda Shaban Zika
11. Martina Klodian Ndoni
12. Nevila Tomor Rruga (Balliu)
13. Drisena Hysen Tallalli
14. Gentjan Mustafa Liçi
15. Esmeralda Fetah Bilibashi
16. Rovena Gezim Stirnberg (Kallashi)
17. Xhulian Arben Gurashi
18. Geralda Mirash Zaganjori
19. Eno Kristo Strakosha
20. Asmiralda Vesel Çeka
21. Irini Ilia Seva
22. Edlira Sabri Ahmetaj (Hutra)
23. Juri Albert Hamiti
24. Lisandër Janis Saraçaj
25. Etleva Tahir Begu (Qama)
26. Edlira Daut Paloja
27. Elda Dhimitër Strakosha (Dhamo)
28. Erjon Sadri Buçpapaj
29. Xhulio Shaqir Shehu
30. Gabriella Gojko Kontiq
31. Valmira Fari Mançka (Stergu)
32. Danijel Kastriot Brajoviq

33. Kristi Dritan Ilia
34. Alketa Sinan Ilia (Graçi)
35. Mateo Dritan Ilia
36. Arald Arben Haveriku
37. Ani Shkëlqim Nebiaj
38. Eralda Jorgo Loli (Regazi)
39. Bradly Isabel Bledar Loli
40. Vivienne Sophie Bledar Loli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM

Nr. 13, datë 18.1.2023

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 122, DATË 5.3.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR ‘UNAZA E
MADHE E TIRANËS (KOMUNA E
PARISIT-RRUGA E KAVAJËS)’, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 122, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:
“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën



bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqet “tokë”, me vlerë 464 014 103.6 (katërqind e gjashtëdhjetë e katër milionë e katëmbëdhjetë mijë e njëqind e tre pikë gjashtë) lekë, “objekte”, me vlerë 552 299 823 (pesëqind e pesëdhjetë e dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e tre) lekë, “kultura bujqësore”, me vlerë 1 561 500 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë, dhe “truall”, me vlerë 737 208 (shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetë) lekë”.

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për “tokë”, “objekte”, “truall” dhe “kultura bujqësore” është 1 018 612 634.6 (një miliard e tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër pikë gjashtë) lekë.”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 6.1, me këtë përmbajtje:

“6.1 Vlera shtesë e shpronësimit, prej 1 063 927 (një milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e

njëzet e shtatë) lekësh, përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.”.

II. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

III. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

IV. Tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 122 datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, i shtohet edhe tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

V. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në 122, DATË 5.3.2014, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘UNAZA E MADHE E TIRANËS (KOMUNA E PARISIT-RRUGA E KAVAJËS)’, TË NDRYSHUAR”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Numri ipasurisë	Sip. totale m ²	Lloji i pasurisë	TOKË TRUALL			TOKE ARË			Ndërtesë soc., ek.		Vlera totale (lek)	SHËNIME	ADRESA
								Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera lekë	Sipërfaqe e shpronësuar	Çmimi (lek/m ²)	Vlera lek	Sipërfaqe e shpronësuar	Vlera sipas preventivit			
1	SEID	OSMAN	MERSINI	3292	112/55	250	TRUALL	6	3,413	20,478				16	326,719	347,197	Kufizohen veprimet mbi pasurinë në bazë të SHK ZQRPP nr. 6287/3, datë 26.10.2006, deri në një urdhër të dytë. Urdhri nr. 1914, datë 26.9.2011.	Tiranë
2	ADELINA	ISA	BANA	3292	100/40	210	TRUALL	210	3,413	716,730						716,730	Konfirmuar nga ASHK-ja Tiranë	Tiranë
	AVDULLA	DURO	BANA															
TOTALI										737,208				326,719	1,063,927			



VENDIM
Nr. 15, datë 18.1.2023

**PËR MBYLLJEN E MISIONIT TË
POSAÇËM TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË KIEV, UKRAINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e Misionit të Posaçëm të Republikës së Shqipërisë në Kiev, Ukrainë.
2. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 16, datë 18.1.2023

**PËR HAPJEN E MISIONIT
DIPLOMATIK TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË KRYEQYTETIN E
UKRAINËS, KIEV**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e Misionit Diplomatik “Ambasadë” të Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin e Ukrainës, Kiev.
2. Për hapjen e këtij misioni diplomatik, shpenzimet do të përballohen nga buxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2023.

3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 17, datë 18.1.2023

**PËR NGARKIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT, SI ORGAN QENDROR
BLERËS, PËR REALIZIMIN E
KONKURSIT TË PROJEKTIMIT PËR
PROJEKTIDETË E RIKONCEPTIMIT
TË KOMPLEKSEVE SPORTIVE TË
STADIUMEVE NË QYTETET E
DURRËSIT, KORÇËS DHE VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e rikonceptimit të komplekseve sportive, si më poshtë vijon:

- a) Stadiumi “Niko Dovana”, Durrës;
- b) Stadiumi “Skënderbeu”, Korçë;
- c) Stadiumi “Flamurtari”, Vlorë.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM
Nr. 18, datë 18.1.2023

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE TË
ARSIMIT TË LARTË NË BALLKANIN
PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE
TË ARSIMIT TË LARTË NË
BALLKANIN PERËNDIMOR

Përfaqësuesit e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës*, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë (më poshtë bashkërisht “Palët” dhe individualisht “Pala”),

duke marrë parasysh Deklaratën e Liderëve të Ballkanit Perëndimor për Tregun e Përbashkët Rajonal, një katalizator për integrim më të thellë ekonomik rajonal dhe një hap drejt Tregut të Vetëm të BE-së, të miratuar në Samitin e Liderëve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit, të organizuar në Sofje më 10 nëntor 2020;

duke e njohur arsimin e lartë si një të mirë publike dhe përgjegjësi publike dhe duke qenë të vetëdijshëm për nevojën për të mbështetur dhe

mbrojtur parimet e lirisë akademike dhe të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë;

duke dasbur të nxisin dhe forcojnë lidhjet e ngushta dhe të zgjerojnë themelet e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor, dhe të zhvillojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimor të Palëve, dhe të nxisin lëvizshmërinë akademike;

të bindur se njohja e kualifikimeve në lidhje me arsimin e lartë do të lehtësojë mësimin dhe zhvillimin e njohurive të ndërvarura nëpërmjet mobilitetit të studentëve, akademikëve, studiuesve dhe profesionistëve dhe do të rrisë bashkëpunimin në arsimin e lartë;

të angazhuar për t’iu përgjigjur nevojës për një Konventë Globale për njohjen e kualifikimeve në fushën e arsimit të lartë për të plotësuar marrëveshjet rajonale për njohjen e kualifikimeve, në lidhje me arsimin e lartë dhe për të rritur kohezionin ndërmjet tyre;

duke iu referuar Konventës për Njohjen e Kualifikimeve, në lidhje me Arsimin e Lartë në Rajonin Evropian dhe angazhimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), duke përfshirë zbatimin e mjeteve të Procesit të Bolonjës;

duke pasur parasysh zhvillimin e mekanizmave të jashtëm dhe të brendshëm të sigurimit të cilësisë bazuar në Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA);

bazuar në nevojën për të gjetur zgjidhje të përbashkëta, praktike dhe transparente për përmirësimin e praktikave të njohjes në arsimin e lartë përmes vendosjes së një standardi dhe procedurave për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë;

të bindur se kjo Marrëveshje do të promovojë mobilitetin akademik, si dhe bashkëpunimin në lidhje me procedurat e drejta dhe transparente për njohjen dhe sigurimin e cilësisë dhe integritetin akademik në arsimin e lartë në Ballkanin Perëndimor;

bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

I. Kjo Marrëveshje rregullon njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë, vazhdimin e

* Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimet ndaj statusit dhe është në përputhje me rezolutën 1244/1999 dhe opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



studimeve dhe aksesin në tregun e parregulluar të punës në secilën nga Palët.

II. Kjo Marrëveshje zbatohet për kualifikimet e Arsimit të Lartë (AL) të marra në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) publike të akredituara të Palëve, lista e të cilave do të specifikohet më tej nga Komisioni i Përbashkët i krijuar sipas nenit 6.

III. Juridiksioni i institucioneve individuale të arsimit të lartë të Palëve ruhet për qëllimin e aksesit në arsimin e lartë, vazhdimin e studimeve dhe marrjen e kualifikimeve të arsimit të lartë. Palët e ushtrojnë këtë juridiksion, në kuadrin e autonomisë së tyre dhe në përputhje me sistemet e tyre përkatëse, duke marrë parasysh kuadrin koordinues që përcakton kjo Marrëveshje.

IV. Korrespondenca ndërmjet kualifikimeve të arsimit të lartë të përcaktuara në këtë Marrëveshje nuk nënkupton përjashtimin nga detyrimet e tjera që lidhen me aksesin në IAL-të e Palëve, regjistrimin në programin e studimit.

V. Kjo marrëveshje nuk paragjykon dhe nuk do të derogojë asnjë organizim, praktikë ose marrëveshje të mëparshme ndërmjet dy ose më shumë Palëve që është më e dobishme për personat fizikë/mbajtësit e kualifikimeve të arsimit të lartë dhe nuk paraqet pengesë për krijimin e ndonjë një organizimi ose marrëveshje të tillë të mëtejshme.

Neni 2

Njohja e kualifikimeve të Arsimit të Lartë

I. Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, kualifikimi i arsimit të lartë përfaqëson çdo dokument, diplomë ose certifikatë tjetër të lëshuar nga një institucion kompetent i AL-së i njërës prej Palëve, që vërteton përfundimin me sukses të një programi studimi të ofruar nga një institucion i akredituar.

II. Njohja e kualifikimeve të arsimit të lartë të lëshuara nga IAL-të e Palëve në përfundim të programit përkatës të studimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Palën përkatëse, do të realizohet në përputhje me korrespondencën, e cila, gjithashtu, specifikon procedurat dhe rregullat e njohjes si më poshtë:

- Kualifikimet do të vlerësohen dhe njihen në përputhje me të drejtën e fituar nga kualifikimi në Palën lëshuese;

- Palët do të njohin kualifikimet në mënyrë fleksibël dhe vetëm dallimet thelbësore që duhet të

shtjellohen, mund të çojnë në mosnjohje. Me kërkesë të qendrave të tjera ENIC/NARIC, një qendër ENIC/NARIC do të përgjigjet brenda një jave ose do të informojë se nevojitet një hetim shtesë;

- Për marrjen e informacionit shtesë, me kërkesë të një qendre ENIC/NARIC i Palës përkatëse, çdo institucion i Palës duhet të përgjigjet brenda 7 ditëve.

Neni 3

Programe të tjera studimi të arsimit të lartë

Kualifikimet e kurseve të shkurtra dhe të kurseve të tjera arsimore të ofruara nga IAL-të e Palëve mund të vlerësohen dhe të njihen si të vlefshme, për aq kohë sa ato sigurojnë arritjen e arsimit të lartë që përkon me ECTS-të ose rezultatet e të nxënës, si dhe në lidhje me nivelin përkatës të kornizës së kualifikimit dhe rregulloret përkatëse të Palëve.

Neni 4

Njohja e kualifikimeve për qëllime të aksesit në kurset e nivelit tjetër

Regjistrimi në programet e studimit i nënshtrohet respektimit të rregulloreve të brendshme të IAL-ve në Palën pritëse.

Neni 5

Bashkëpunimi mes qendrave ENIC/NARIC

Për të lehtësuar vlerësimin e kualifikimeve të Arsimit të Lartë (AL) të lëshuara nga IAL-të përkatëse dhe për të rritur aftësitë e vlerësimit të kualifikimeve të huaja të AL, të paraqitura edhe nga sistemet e palëve të treta, Palët marrin përsipër të inkurajojnë bashkëpunimin maksimal midis qendrave përkatëse të brendshme të njohjes (Qendrat ENIC/NARIC), duke përfshirë shkëmbimin dhe ndarjen e përvojave, mjeteve dhe bazave të të dhënave, bashkëpunimin përmes Bazës së të Dhënave Rajonale të Njohjes së Ballkanit Perëndimor (RRD), si dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre për zbatimin e projekteve që lidhen me vlerësimin e kualifikimeve të AL-ve, transparencën në dokumentacionin që duhet paraqitur për njohjen e kualifikimeve të huaja



të AL-ve dhe për të luftuar fenomenin e falsifikimit të dokumenteve të dhëna nga IAL-të.

Për të shmangur fenomenin e falsifikimit përmendur në paragrafin më lart, çdo IAL e Palëve është e detyruar t'i përgjigjet kërkesës së qendrave ENIC/NARIC të Palëve, pa pagesë dhe brenda 14 ditëve nga marrja e kërkesës për konfirmimin e originalitetit të kualifikimit.

Neni 6

Komisioni i Përbashkët për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të krijohet një Komision i Përbashkët për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë (Komisioni), i cili do të ngarkohet me organizimin, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

I. Komisioni i Përbashkët do të përbëhet nga tre përfaqësues të secilës Palë.

II. Puna e Komisionit të Përbashkët do të koordinohet nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në bashkëpunim me Iniciativën e Reformës Arsimore të Evropës Juglindore (ERI SEE).

Neni 8

I. Palët do t'i japin Komisionit të Përbashkët listën e tyre të IAL-ve të akredituara, objekt i kësaj Marrëveshjeje, jo më vonë se 3 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, e cila mund të rishikohet nga Komisioni i Përbashkët nëse njëra nga Palët e kërkon këtë.

II. Komisioni i Përbashkët do të takohet të paktën dy herë në vit, ose me kërkesë të një Palë, dhe do t'u raportojë çdo vit palëve në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

III. Komisioni i Përbashkët do të miratojë Rregulloren e Funkcionimit të tij.

IV. Të gjitha vendimet e Komisionit të Përbashkët do të merren me konsensus të të gjitha Palëve.

Neni 9

Komisioni i Përbashkët, gjithashtu, do të përqendrohet, por nuk kufizohet vetëm në:

a) lehtësimin e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet Agjencive të Sigurimit të Cilësisë, duke përfshirë vizitat në Agjencitë e Akreditimit, nëse është e zbatueshme;

b) lehtësimin e bashkëpunimit të butë të institucioneve përkatëse nëpërmjet RRD-së;

c) trajtimin e çështjeve që lidhen me dallimet thelbësore në lidhje me njohjen e kualifikimeve;

d) analizimin e çështjeve të ndryshme në lidhje me njohjen e kualifikimeve dhe propozimin e veprimeve të përbashkëta.

Neni 10

Komisioni i Përbashkët shqyrton dhe miraton përditësimet e listave të ofruara nga palët për të pasqyruar ndryshimet në statusin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë të Palëve. Këto përditësime do të respektojnë përgjegjësinë e Palëve për organizimin e sistemeve arsimore.

Neni 11

Dispozita tranzitore dhe përfundimtare

Kjo Marrëveshje do të ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim të të gjitha Palëve, duke iu nënshtruar së njëjtës procedurë të nevojshme për të lidhur këtë Marrëveshje.

Neni 12

Fushëveprimi i kësaj Marrëveshjeje mund të zgjerohet në IAL-të private të akredituara, me pëlqimin me shkrim të të gjitha Palëve.

Neni 13

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që lind nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të diskutohet brenda Komisionit të Përbashkët të krijuar sipas nenit 6.

Neni 14

Hyrja në fuqi

I. Kjo Marrëveshje u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit sipas kërkesave të parashikuara nga legjislacioni përkatës i Palëve. Njoftimi zyrtar i ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohet te Depozitari.



II. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e 30 (tridhjetë) pas depozitimit të njoftimit të tretë zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit për ato Palë që kanë depozituar njoftimin e tyre zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

III. Për çdo Palë që depoziton njoftimin e saj zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit pas datës së depozitimit të njoftimit të tretë zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas ditës kur kjo Palë depoziton njoftimin e saj zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

IV. Maqedonia e Veriut do të veprojë si Depozitare dhe do të njoftojë të gjitha palët për çdo njoftim të marrë sipas këtij neni dhe çdo akt ose njoftim tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 15

Nëse njëra Palë tërhiqet nga kjo marrëveshje, marrëveshja do të pushojë së qeni efektive vetëm për atë Palë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të njoftimit të saj te Depozitari.

Neni 16

Tërheqja nga kjo Marrëveshje nuk do të ketë asnjë ndikim, në lidhje me:

a) vendimet e njohjes të marra më parë sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;

b) vlerësimet e njohjes ende në vazhdim sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Marrëveshja është hartuar në gjuhën angleze në versionin origjinal, i cili do të mbetet në zotërim të Depozitarit. Secila Palë do të marrë një kopje të certifikuar të Marrëveshjes.

Bërë në Berlin, më 3.11.2022.

[nënshkrimet]

VENDIM

Nr. 19, datë 18.1.2023

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” VRESHT NË “TOKË URBANE” TRUALL TË SIPËRFAQES 390.99 m², PJESË E PASURISË ME NUMËR 1/394, DHE TË SIPËRFAQES 269.13 m², PJESË E PASURISË ME NUMËR 2/465, ZONA KADASTRALE 1476, BASHKIA DROPULL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e kategorisë së resursit “tokë bujqësore” vresht në “tokë urbane” truall të sipërfaqes 390.99 m², pjesë e pasurisë me numër 1/394, dhe të sipërfaqes 269.13 m², pjesë e pasurisë me numër 2/465, zona kadastrale 1476, Bashkia Dropull, sipas certifikatave të pasurisë, planeve të rlevimit dhe të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Gjirokastrë, pasqyron në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga “tokë bujqësore” vresht në “tokë urbane”, të sipërfaqes 390.99 m², pjesë e pasurisë me numër 1/394, dhe të sipërfaqes 269.13 m², pjesë e pasurisë me numër 2/465, zona kadastrale 1476, Bashkia Dropull.

3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastrë kryen ndryshimin e llojit të pasurisë në certifikatën e pasurisë, sipas të dhënave për pasuritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), qarku Gjirokastrë, dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastrë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

*Lidhja nr. 1*

Nr. rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja në m ²	Sipërfaqja ndërtimore m ²	Emërtimi i strukturës
1	Gjirokastrë	Dropull	1476	Gjirokastrë	1/394	700	390.99	Objekt agroturistik
2	Gjirokastrë	Dropull	1476	Gjirokastrë, Dervician	2/465	500	269.13	Objekt agroturistik



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI MARIANA THODHOR NDRICO		DATE 10/01/2023	QELLIMI NDRYSHIM KATEGORIE
VENDNDODHJA			
BASHKIA DROPULL		DVASHK/ZVASHK GJIROKASTER	ZONA KADASTRALE 1476 NUMRI PASURISE 2/456
INDEX HARTEK-34-137-(214-D)			
TE DHENAT E PASURISE			
LLOJI PASURISE VRESHT		SIP.PASURISE= 500 m2	SIPERFAQE E PASURISE QE DO TE TJETERSOHE = 269.13 m2
		NUMRI KATEVE	NUMRI PEMEVE

X 514914
Y 4434528
KORNIZA GJEOREFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE
X 515109
Y 4434528

SHPJEGUES

PER NDARJE PASURIE:

Parcela 2/456 = 500 m2 vijon Parcela VRESHT = 230.87 m2
Parcela TRUALL = 269.13 m2

KUFIRI I PAS. VRESHT ■ SIPERFAQE =230.87m2

KUFIRI I PASURISE TRUALL ■ SIPERFAQE =269.13 m2

X 514914
Y 4434403
SH 1:1000
X 515109
Y 4434403

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			2/888		
2	LINDJE			1/394		
3	JUG			2/466		
4	PERENDIM			2/102		

<p>REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT</p> <p>EMRI: _____</p> <p>LICENCA: NR. _____ DATE _____</p> <p>KOMPANIA: _____</p> <p>NIPT: _____</p> <p>NENSHKRIMI/VULA _____</p> <p>REALIZOI PER ASHK</p> <p>SPECIALISTI <i>Basil Dine</i></p> <p>DVASHK <i>GJIROKASTER</i></p> <p>NENSHKRIMI _____</p> <p>KONFIRMOI</p> <p>PERGJEGJESI/DREJTORI _____</p> <p>NENSHKRIMI / VULA _____</p>	<p>TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O.</p> <p>Kode per teknologjine e matjeve: T-Teren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;</p> <p>PERCAKTIMI KUFIRIT: P</p> <p>Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;</p> <p>SHENIME TE VECANTA:</p> <p>PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET</p> <p>EMRI _____</p> <p>NENSHKRIMI _____</p>
---	--

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Teren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI MARIANA THODHOR NDRICO **DATE** 10/01/2023 **QELIMI** NDRYSHIM KATEGORIE

VENDNDODHJA
 BASHKIA DROPULL DVASHK/ZVASHK GJIROKASTER ZONA KADASTRALE 1476 NUMRI PASURISE 1/394 INDEX HARTEK-34-137-(214-D)

TE DHENAT E PASURISE
 LLOJI PASURISE VRESHT SIP.PASURISE= 700 m2 SIPERFAQE E PJESES QE DO TE TJETERSOHET = 390.99 m2 NUMRI KATEVE NUMRI PEMEVE

KORNIZA GJEOREFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 514916 Y 4434528 X 515110 Y 4434520

SHPJEGUES

PER NDARJE PASURIE:
 Parcela 1/394 = 700 m2 vijon Parcela VRESHT = 309.01 m2
 Parcela TRUALL = 390.99 m2

KUFIRI I PASURISE VRESHT SIPERFAQE = 309.01 m2

KUFIRI I PASURISE TRUALL SIPERFAQE = 390.99 m2

X 514916 Y 4434395 SH 1:1000 X 515110 Y 4434395

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			2/888		
2	LINDJE			2/395		
3	JUG			2/450		
4	PERENDIM			2/465		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT
 EMRI: _____
 LICENCA: NR. _____ DATE _____
 KOMPANIA: _____
 NIPT: _____
 NENSHKRIMI/VULA _____

REALIZOI PER ASHK
 SPECIALISTI *Hande Dine*
 DVASHK *GJIROKASTER*
 NENSHKRIMI _____

KONFIRMOI
 PERGJEGJESI/DREJTORI _____
 NENSHKRIMI / VULA _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O.
 Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: P
 Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI _____
 NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimit kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI MARIANA THODHOR NDRICO **DATE** 10/01/2023 **QELLIMI** NDRYSHIM KATEGORIE

VENDNDODHJA:
 BASHKIA DROPULL DVASHK/ZVASHK GJIROKASTER ZONA KADASTRALE 1476 NUMRI PASURISE 2/456+1/394 INDEX HARTEK-34-137-(214-D)
 TE DHENAT E PASURISE
 LLOJI PASURISE VRESHT SIP.PASURISE= 1200 m2 SIPERFAQE E PASURISE QE DO TE TJETERSOHET = 664.33 m2 NUMRI KATEVE NUMRI PEMEVE__

X 514914 **KORNIZA GJEOREFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE** X 515109
 Y 4434528 Y 4434528

SH 1:1000

SHPJEGUES

PER BASHKIM PASURIE:
 Parcela 2/456 = 500 m2 Parcela VRESHT = 535.67 m2
 + Parcela 1/394 = 700 m2 Parcela TRUALL = 664.33 m2

KUFIRI I PAS. VRESHT XXXX SIPERFAQE = 535.67 m2
KUFIRI I PASURISE TRUALL XXXX SIPERFAQE = 664.33 m2

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			2/888		
2	LINDJE			1/395		
3	JUG			2/466		
4	PERENDIM			2/102		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT
 EMRI: _____
 LICENCA: NR. _____ DATE _____
 KOMPANIA: _____
 NIPT: _____
 NENSHKRIMI/VULA _____

REALIZOI PER ASHK
 SPECIALISTI Beqir Dine
 DVASHK GJIROKASTER
 NENSHKRIMI _____

KONFIRMOI
 PERGJEGJESI/DREJTORI _____ EMRI _____
 NENSHKRIMI / VULA _____ NENSHKRIMI _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O.
 Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: P
 Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT			
Emri (Emër, Atësi dhe Mbiemër)	Nr. Personal Id	Pjesa(-/-)	
Mariana Thodhor Ndrico	H35317026P	1/1	

Numri i Pasurisë	2/465		
Kodi Unik	1476019059		
Zona Kadastrale	1476		
Lloji i Pasurisë	VRESHTE		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 500	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë			
Adresa e Pasurisë	GJIROKASTËR, DERVICIAN		

DREJTORI Florjan Taçi	Florjan Taçi Taci <div style="font-size: small; margin-top: 5px;"> Digitally signed by: Florjan Taçi Date: 2021.04.20 01:52:43 +02'00' </div>	Data e lëshimit 19/04/2021
---------------------------------	---	-----------------------------------




Vulosur elektronikisht nga Drejtorja
 Vendore Gjirokaster
 Date: 2021/04/20 13:51:58 +02'00'
 H35317026P2021042013515138L1014





AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

Miratuar me VAKM 792, Date 07.10.2020

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
 të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1476019059
(Nga ____, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1476, Lloji i Pasurisë: VRESHTE, Nr. i Pasurisë: 2/465, Sipërfaqja Totale 500 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-137-(214-B), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia DERVICIAN, Rruga ____, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Vlera e Pasurisë:
Fillestare __ (Akti Nr. __, Dt. ____), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: Mariana Thodhor Ndrico, Nr. Identifikimi/NIPT H35317026P, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia -, Rruga ____, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____, Nr. __, Datë: ____
Regjistruar: Nr. 00000988, Datë: 19/04/2021

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____, me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____, Nr. __, Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __, Datë: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____
 Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____
 Përshkrimi: _____

DREJTORI
Florjan Taçi

Florjan
Taçi

Digitally signed by:
Florjan Taçi
Date: 2022.05.04
05:59:43 +02'00'

Data e lëshimit 04/05/2022




Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Gjirokastrë
Date: 2022.05.04 17:59:16 +02'00'
H35317026P2022090417591014ASHK

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastresë)

2/2






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHËTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 1476	KODI UNIK: 1476019059
NUMRI I PASURISE: 2/465	INDEKSI I HARTES: K-34-137-(214-D)


KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:2500

<p>DREJTORI Emer Mbiemer)</p>	<p>Data e përgatitjes: 30// 08//2021</p>	<p>SHPJEGUES</p> <p><input type="checkbox"/> PARCELA</p> <p><input checked="" type="checkbox"/> NDERTESA</p>
--	--	---





Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Gjrokastër
Data: 2022/05/04 18:03:05 +02'00'
#35317026P2022050418025834014

**Florjan
Taci**

Digitally signed by Florjan Taci
Date: 2022.05.04 06:01:45
+02'00'

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Gjrokastër)



SI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri (Emër, Atësi dhe Mbiemër)	Nr. Personal Id	Pjesa(-/)
Mariana Thodhor Ndrico	H35317026P	1/1

Numri i Pasurisë	1/394		
Kodi Unik	1476008212		
Zona Kadastrale	1476		
Lloji i Pasurisë	VRESHTE		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 700	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë			
Adresa e Pasurisë	GJIROKASTËR		

DREJTORI Florjan Taçi	Florjan Taçi Taci	Digitally signed by Florjan Taçi Date: 2021.04.20 01:59:43 +02'00'	Data e lëshimit 19/04/2021
---------------------------------	----------------------	---	-----------------------------------

  Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Gjirokastrë
Date: 2021/04/20 13:59:22 +02'00'
H35317026P2021042013591582L1014

 **ASHK**
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

Miratuar me VKM 782, Datë 07.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1476008212
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1476, Lloji i Pasurisë: VRESHTE, Nr. i Pasurisë: 1/394, Sipërfaqja Totale 700 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale -, Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Vlera e Pasurisë:
Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: Mariana Thodhor Ndrico, Nr. Identifikimi/NIPT H35317026P, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____
Regjistruar: Nr. 00000988, Datë: 19/04/2021

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____
Përshkrimi i Objektivit të Aktit: _____
Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



SH



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkuues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: _____

DREJTORI
Florjan Taçi

Florjan
Taçi

Digitally signed by:
Florjan Taçi
Date: 2022.05.04
05:58:56 +02'00'

Data e lëshimit 04/05/2022



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Gjyrokastër
Date: 2022/05/04 17:58:27 +02'00'
H35317026P2022050417582076ASHK

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadashtës)

2/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE



ZONA KADASTRALE: 1476	KODI UNIK: 1476008212
NUMRI I PASURISE: 1/394	INDEKSI I HARTES: K-34-137-(214-D)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

SH 1:2500

DREJTORI
(Emer Mbiemer)

Data e përgatitjes: 12// 01//2022

  Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Gjrokastër
Date: 2022/05/04 18:02:11 +02:00
H36317026P2022050418020344014

Florian Tac
Florian Tac

Digitally signed by Florian Tac
Date: 2022.05.04 18:01:45 +02:00

SHPJEGUES
□ PARCELA
□ NDERTESA

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Gjrokastër)



VENDIM
Nr. 20, datë 18.1.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 298, DATË 20.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË TURIZMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 7, e kreut I, të vendimit nr. 298, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Marrëdhëniet e punës të drejtorit të përgjithshëm dhe të punonjësve të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, ‘Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar.”.

2. Për nëpunësit aktualë të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësit civil në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 21, datë 18.1.2023

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË TEATRIT KOMBËTAR EKSPERIMENTAL “KUJTIM SPAHIVOGLI”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar,

me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Gjergj Prevazi emërohet drejtor i Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 10, datë 19.1.2023

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 207, DATË 28.10.2022, “PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 46 dhe 50 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 207, datë 28.10.2022, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas pikës 3 të udhëzimit, shtohet pika 3/1 me përmbajtje, si më poshtë:

“3/1. Caktimin e zgjedhësve në listën e qendrës së votimit përkatëse, sipas kodit të vendbanimit.

Renditja e zgjedhësve brenda qendrës së votimit bëhet sipas rendit alfabetik të mbiemrit.”.

2. Pas pikës 11 të udhëzimit shtohet pika 11/1 me përmbajtje, si më poshtë:

“11/1. Procedura e parashikuar në pikën 3/1 të këtij udhëzimi kryhet për çdo ekstrakt të listës së zgjedhësve që do të hartohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi
Faqe | 789

**URDHËR****Nr. 4, datë 13.1.2023****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 28.5.2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”; të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. Mimoza Dhëmbi, me detyrë drejtor i përgjithshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të gjitha procedurat

e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë do të ushtrohen nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në një urdhër të dytë.

3. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 311, datë 21.11.2022, “Për miratimin e rregullores ‘Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 165, datë 13.12.2022, bëhet korrigjimi i aneksit të munguar, **duke shtuar aneksin nr. 8 të përbërë nga dy tabela.**



ANEKSI NR. 8

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E DOKUMENTEVE LIGJORE TË PËRPILUARA NGA PROKURORI I KOMANDUAR SIPAS POZICIONIT/ROLIT, PËR VITIN _____

Nr.	Dokumenti ligjor	Objekti	Data e marrjes në dorëzim	Afati i verifikimit	Krahasuar me afatin ligjor, nënligjor ose të rakorduar	Kthimi i dokumentit ligjor	Shkaku ¹

¹ Shkaqe të kthimit sipas metodologjisë janë tri : a) kthimi i dokumentit ligjor për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentit; b) kthimi i dokumentit ligjor për shkak të gabimeve materiale ose mospërputhje me metodologjinë e unifikuar apo rakorduar; dhe c) kthimi i dosjes për shkak të parregullsisë të dokumentacionit.



TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E DOKUMENTEVE LIGJORE TË PËRPILUARA NGA PROKURORI I KOMANDUAR GJATË KRYERJES SË DETYRAVE TË TJERA TË PËRGJITHSHME (JASHTË POZICIONIT/ROLIT), PËR VITIN _____

Nr.	Dokumenti ligjor	Objekti	Data e marrjes në dorëzim	Afati i verifikimit	Krahasuar me afatin ligjor, nënligjor ose të rakorduar	Kthimi i dokumentit ligjor	Shkaku ²

² Shkaqe të kthimit sipas metodologjisë janë tri : a) kthimi i dokumentit ligjor për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentit; b) kthimi i dokumentit ligjor për shkak të gabimeve materiale ose mospërputhje me metodologjinë e unifikuar apo rakorduar; dhe c) kthimi i dosjes për shkak të parregullsisë të dokumentacionit.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë